

V E N D I M
Nr.203, datë 4.5.1993

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.345, DATË
10.8.1992 "PËR SHPËRBLIMIN E PUNËS SË PUNONJËSVE"**

Në zbatim të ligjit nr.7702, datë 22.4.1993 "Për disa ndryshime në ligjin nr.7583, datë 13.7.1992 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.345, datë 10.8.1992 bëhen këto ndryshime:

a) Pika 10 ndryshohet si vijon:

"Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, rrethet, bashkitë dhe komunat ushtrojnë kontroll për rritjen e pagës mesatare mujore në ndërmarrjet shtetërore, institucionet shtetërore jobuxhetore dhe pjesërisht jobuxhetore të vartësisë së tyre.

- Nëse ndërmarrja shtetërore, institucioni shtetëror jobuxhetor dhe pjesërisht jobuxhetor rritin pagën mesatare mujore deri në 5 për qind mbi masën e rritjes në përqindje të miratuar nga Këshilli i Ministrave në shkallë vendi nuk zbatohet asnjë sanksion.

- Nëse ndërmarrja shtetërore, institucioni shtetëror jobuxhetor dhe pjesërisht jobuxhetor rritin pagën mesatare mujore mbi 5 deri 20 për qind mbi masën e rritjes në përqindje të miratuar nga Këshilli i Ministrave, nuk zbatohet asnjë sanksion, vetëm për rastet kur ajo plotëson edhe këto kriteret financiare: Nuk ka detyrime tatimore ndaj Buxhetit të Shtetit, ndaj kredive dhe interesave bankare, ndaj kontributit të sigurimeve shoqërore, të përkrahjes sociale, detyrimeve të tjera të ngjashme me to të papaguara në afat dhe rentabiliteti të mos jetë më i ulët se në periudhën e mëparshme (në vartësi nga periudha e zgjedhur për kontroll), përndryshe atyre nuk u lind e drejta e rritjes së pagës mesatare.

- Nëse ndërmarrja shtetërore, institucioni shtetëror jobuxhetor dhe pjesërisht jobuxhetor rritin pagën mesatare mujore mbi 20 për qind mbi masën e miratuar në përqindje nga Këshilli i Ministrave, edhe kur plotësohen kriteret financiare të përcaktuara në paragrafin e mësipërm, detyrohen të derdhin në Buxhetin e Shtetit një pjesë të fitimit, baras me 500 për qind të kësaj rritjeje".

b) Pas pikës 11 shtohet pika 11/a me këtë përmbajtje:

"Sipas ligjit quhet shkelje fshehja dhe falsifikimi i të dhënave të deklaratës, mosparaqitja në afatin e caktuar e deklaratës, mosrespektimi i afateve të derdhjes në buxhet që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji.

Shkeljet e mësipërme dënohen me këto masa administrative:

- Fshehja dhe falsifikimi i të dhënave të deklaratës me gjobë në masën 5-fish të shumës së fshehur ose të falsifikuar;

- mosparaqitja në afatin e caktuar e deklaratës me gjobë nga 6000 deri në 8000 lekë dhe paguhet nga drejtori i ndërmarrjes ose i institucionit shtetëror jobuxhetor dhe pjesërisht jobuxhetor;

- mosrespektimi i afateve të derdhjes në buxhet me gjobë nga 6000 deri në 8000 lekë dhe paguhet nga kryetari i degës që mbulon pagat dhe drejtori i ndërmarrjes ose institucionit shtetëror jobuxhetor dhe pjesërisht jobuxhetor".

c) Pika 12 ndryshohet si vijon:

"Të drejtën e gjobës e kanë punonjësit e caktuar për të ndjekur problemet e pagave përkatësisht në ministri, rreth, bashki e komunë.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes ose njoftimit të tij, përkatësisht te titullari në ministri, në rreth, bashki dhe komunë, akti i të cilëve është i formës së prerë".

ç) Pas pikës 12 shtohet pika 12/a me këtë përmbajtje:

"Detyrimet që i lindin ndërmarrjes shtetërore, institucionit shtetëror jobuxhetor dhe pjesërisht jobuxhetor nga sanksionet e parashikuara në pikën 10 të këtij vendimi, derdhen në Buxhetin e Shtetit si të gjitha detyrimet e tjera".

2. Punonjësit të ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore, rretheve, bashkive dhe komunave që janë caktuar të ushtrojnë kontroll mbi pagat, për natyrë të veçantë të punës, t'u jepet 20 për qind shtesë mbi pagën bazë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi